

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I PARË

VENDIM

Aplikimi nr. 21634/15

Mirela Sinani kundër Shqipërisë

dhe 6 aplikime të tjera

(shikoni listën bashkangjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i parë), e mbledhur më 10 maj 2016, si një Komitet, i përbërë nga:

Aleš Pejchal, *president*

Ledi Bianku,

Armen Harutyunyan, *gjykatës,*

dhe Abel Campos, *regjistrar i seksionit,*

pasi ka shqyrtuar aplikimet e mësipërme,

pasi ka shqyrtuar deklaratimet formale në të cilat pranohet një zgjidhje e çështjeve në mënyrë miqësore,

pasi ka diskutuar, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Një listë me ankuesit paraqitet në shtojcë.

Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj, znj. A. Hicka nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

Ankuesit paraqitën shqetësimet e tyre bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës për kohëzgjatjen e procedimeve civile.

Më 25 janar dhe 8 mars 2016, në Gjykatë u dorëzuan deklarata për një zgjidhje të çështjes në mënyrë miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave, në lidhje me aplikimet nr. 21634/15, 21693/15, 25430/15, 27429/15, 30171/15 dhe 30175/15, ankuesit binin dakord të hiqnin dorë nga kërkesa të tjera ndaj Shqipërisë, për sa u përket fakteve nga të cilat lindnin këto aplikime: ndaj një premtimi të Qeverisë për t'iu paguar secilit 1100 euro (një mijë e njëqind euro) për të mbuluar të gjitha dhe çdo dëm jomonetar, si edhe kostot dhe shpenzimet.

Për sa i përket aplikimit nr. 27438/15, ankuesi ra dakord të hiqte dorë nga çdo kërkesë tjetër kundër Shqipërisë në lidhje me faktet nga të cilat lindi ky aplikim ndaj një premtimi të Qeverisë për t'iu paguar 1700 euro (një mijë e shtatëqind euro), për të mbuluar të gjitha dhe çdo dëm jomonetar, si edhe kostot dhe shpenzimet.

Sipas deklaratimeve për zgjidhje në mënyrë miqësore, shumat e mësipërme do të konvertohen në vlerën monetare vendase me normën e zbatueshme në datën e pagesës, pa përfshirë asnjë taksë që mund të jetë e zbatueshme. Ato do të paguhën brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata. Në rast se këto shuma nuk paguhën në periudhën e caktuar tremujore, Qeveria do të paguajë një interes të thjeshtë për to, që nga përfundimi i asaj periudhe deri në kompensim, me një normë të barabartë me normën marxhinale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospa-gimit plus tre për qind. Pagesat e mësipërme do të përbëjnë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

LIGJI

Gjykata bëhet me dije për zgjidhjen në mënyrë miqësore të arritur midis palëve. Ajo është e kënaqur që zgjidhja bazohet mbi respektimin e të drejtave të njeriut të përcaktuar në Konventë dhe në protokollet e saj dhe nuk gjen asnjë arsye për të justifikuar vijimin e shqyrtimit të ankimeve. Për sa më sipër, është me vend që çështjet të hiqen nga lista.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

Vendos t'i heqë aplikimet nga lista e çështjeve në përputhje me nenin 39 të Konventës.

E hartuar në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 2 qershor 2016.

Abel Campos
(*firmosur*)

Aleš Pejchal
(*firmosur*)

SHTOJÇË

Nr.	Aplikimi nr.	Paraqitur më	Emri i ankuesit Datëlindja Vendbanimi	Përfaqësuar nga
1	21634/15	27.4.2015	Mirela SINANI 9.9.1964 Tiranë	Rudi METAJ
2	21693/15	20.4.2015	Pëllumb HAXHIU 18.3.1952 Tiranë	Rudi METAJ
3	25430/15	13.5.2015	Mirvete RAMA 19.10.1972 Tiranë	Rudi METAJ
4	27429/15	1.6.2015	Kosta KACI 12.4.1963 Gjirokastër	Rudi METAJ
5	27438/15	15.5.2015	Kujtim SHQOPA 16.4.1964 Durrës	Rudi METAJ
6	30171/15	15.6.2015	Pranvera BERBERI 1955 Bilisht	Rudi METAJ
7	30175/15	15.6.2015	Matilda NASKA 20.6.1971 Tiranë	Rudi METAJ